

VENDIM
Nr. 282, datë 18.12.2024

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS LIDHUR ME KËRKESËN E SHOQËRISË
“MET ALBANIA” SHA, PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “d”, 5, pika 1, germa “d”, dhe 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.12.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2498/1 prot., datë 17.12.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘MET Albania’ sh.a. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “MET Albania” sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2498 prot., datë 5.12.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, gjerat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gjerat “a” dhe “c”; për pikën 1.3, gjerat “a” dhe “c”, dhe për pikën 2.4, gjerën “c”.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria duhet të plotësojë më tej dokumentacionin në vijim:

NENI 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1. Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.2. Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- **germa “b”:** Shoqëria duhet të depozitojë dëshminë e penaltetit të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për vetë shoqërinë.

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- **germa “b”:** shoqëria duhet të dokumentojë mbështetjen financiare të mjaftueshme, duke bërë shpërndarjen për secilën veprimtari, duke qenë se paralelisht ka aplikuar dhe për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë.

Pika 2.4. Dokumentacioni specifik për licencën e furnizimit të energjisë elektrike

- **germa “b”:** shoqëria duhet të informojë se si ka parashikuar të sigurojë shërbimin e IT për 6 mujorin e parë të vitit 2025.

- **germa “c”:** shoqëria duhet të informojë se kur do t’i disponojë zyrat përfaqësuese të furnizuesit.

- **germa “d”:** shoqëria duhet të japë informacion mbi mënyrën e realizimit të matjes së energjisë për klientët.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “MET Albania” sh.a. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “MET Albania” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti